



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBËTAR



Tiranë më 18.09.2019

VENDIM

Nr. 8, Datë 18.09.2019

Bazuar në nenin 19.2.3.), të Rregullores së Gjykimit Disiplinor e Profesional në datë 18.09.2019, u thirr Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë nga Presidentja e Urdhrit të Psikologut, për shqyrtimin e ankesës së psikologes Znj. Danjela Blaceri mbi Vendimin Nr 8, Datë 18.07.2019 të Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor e Profesional.

Pasi u njohën me ankesën e çështjes në fjalë, Këshilli Kombëtar:

VENDOSI:

Të rrëzojë Vendimin Nr 8, Datë 18.07.2019 të Komisionit të Etikës, dhe të lërë në fuqi Vendimin Nr 4, Datë 28.02.2019.

1. Vërejtje me paralajmërim për heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit.
2. Gjorbë 10000 lekë të reja.

Sqarojmë Znj. Blaceri se Këshilli Kombëtar në mbledhjen e datës 03.05.2019, pas shqyrtimit të ankesës së Znj. Blaceri datë 03.03.2019 nga një komision ad hoc vendosi të kthejë për rigjykim në Komisionin e Etikës ankesën e bërë ndaj znj. Blaceri për përmbushje të procedurës së seancës dëgjimore bazuar në nenin 14, pika 1 e Rregullores së Gjykimit Disiplinor Profesional si dhe për një vlerësim më të thelluar të çështjes.

Duke qenë se në gjykimin për herë të dytë të çështjes nga Komisioni i Etikës, procedura në fjalë u përmbush (në kushtet e dorëheqjes së një prej anëtarëve të Komisionit të Etikës, të gjithë anëtarët që përbënin këshill në datën në fjalë ishin prezent) dhe nuk rezultoi asnjë provë dhe argumentim shtesë që të mbështesë rritjen e masës disiplinore të marrë nga ky komision në datë 18.07.2019, u vendos që vendimi i mëparshëm të mbetet në fuqi.

PRESIDENTE E URDHRI

Valbona Treska



SEKRETARE

Armira Baboçi

Blv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë, email:
sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035544 51 1804